

Thirrja nga data 27.08.2025 deri në datën 01.09.2025

TERMAT E REFERENCES

PËR

KONSULENT/E LOKAL/E PËR DIZAJNIMIN DHE LEHTËSIMIN E NJË PUNËTORIE MBI PLANIFIKIMIN STRATEGJIK DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR MOBILIZIMIN E BURIMEVE DHE MBLEDHJEN E FONDEVE

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji Qershor të vitit 2022 ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit. Ky projekt synon të fuqizojë pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje përmes krijimit dhe funksionalizimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Asambleja Komunale e Fëmijëve përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në përbërje të saj janë të përfaqësuara komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu, në Asamblesë Komunale të Fëmijëve marrin pjesë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kontribuojnë dhe angazhohen në aktivitetet e ndryshme që organizohen nga anëtarët e saj.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.

2. OBJEKTIVA

Nevo Koncepti kërkon një individë (Ekspert/e) për të ofruar dhe zhvilluar punëtorinë një ditorë për stafin e organizatës Nevo Koncepti. Përmes këtij angazhimi, Nevo Koncepti synon:

- Të rriten kapacitetet e stafit të organizatës Nevo Koncepti për planifikim strategjik, mobilizim burimesh dhe mbledhje fondesh, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e ndikimit të organizatës në komunitet. Të prezantohen parimet bazë dhe konceptet e avancuara të mobilizimit të burimeve dhe fundraising-ut.
- Të aftësohet stafi në hartimin e planeve të qëndrueshme për mbledhjen e fondeve, të lidhura me prioritetet strategjike të organizatës.
- Të zhvillohen teknikat për identifikimin dhe analizimin e burimeve të ndryshme të financimit (donatorë ndërkombëtarë, bizneset lokale, individët dhe komuniteti).
- Të forcohen aftësitë për përgatitjen e propozimeve efektive dhe të bazuara në rezultate për aplikim në fonde/grante.
- Të mësohen qasje inovative në diversifikimin e burimeve (evente, crowdfunding, partneritete publike-private).
- Të përforcohet aftësia e stafit për komunikim strategjik dhe përgatitjen e mesazheve bindëse për mbështetësit potencialë.
- Të aftësohet stafi në përdorimin e mjeteve digjitale dhe platformave online për fushata mbledhjeje fondesh.
- Të inkurajohet bashkëpunimi i brendshëm në organizatë për planifikim dhe ndarje të qartë të roleve në procesin e mobilizimit të burimeve.
- Të përgatiten mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të fundraising-ut për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.
- Të nxiten ide kreative për krijimin e një portofoli të qëndrueshëm partnerësh dhe donatorësh afatgjatë.

3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Konsulenti/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë universitare (Master i preferuar) në shkenca sociale, menaxhim, zhvillim ndërkombëtar, ose fusha të ngjashme.
- Përvojë profesionale e dëshmuar (minimum 5 vite) në fushën e mobilizimit të burimeve, mbledhjes së fondeve dhe menaxhimit të projekteve.
- Eksperiencë praktike në **facilitimin e punëtorive/trajnimeve** për organizata të shoqërisë civile ose institucione publike/private.
- Njohuri të avancuara për **metodat bashkëkohore të fundraising-ut**, përfshirë grantet ndërkombëtare, partneritetet me sektorin privat dhe qasjet inovative (crowdfunding, kampanja digjitale).
- Aftësi të shkëlqyera në **planifikim strategjik, analizë financiare dhe raportim të rezultateve**.
- Shkathtësi të mira në komunikim, prezentim dhe përdorim të mjeteve digjitale për fushata dhe mobilizim të komunitetit.

- Aftësi për të punuar në mënyrë bashkëpunuese me staf të niveleve të ndryshme dhe për të përshtatur përmbajtjen sipas nevojave të organizatës.
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 4 shtator 2025 dhe të përfundojë me datën 19 shtator 2025. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Tituli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të punëtorisë	Zhvillimi / adaptimi i programit të punëtorisë, përfshirë materialet e punëtorisë.	2	Shtator 2025
2	Ofrimi i programit të punëtorisë për Stafin e Organizatës Nevo Koncepti.	Ofrimi i punëtorisë 1-ditor për stafin e Organizatës Nevo Koncepti.	1	Shtator 2025
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin në punëtorinë mbi Konceptin dhe Praktikat më të mira të planifikimit strategjik për mobilizimin e burimeve dhe mbledhjen e fondeve.	1	Shtator 2025
	Gjithsej:		4	

5. REZULTATET E PRITSHME

- **Stafi i organizatës Nevo Koncepti** të ketë njohuri të avancuara për konceptet dhe praktikat më të mira të mobilizimit të burimeve dhe fundraising-ut.
- Të jetë hartuar një draft-plan praktik për mbledhjen e fondeve dhe diversifikimin e burimeve të organizatës.
- Pjesëmarrësit të zhvillojnë aftësi konkrete për:
 - Identifikimin e donatorëve dhe partnerëve të rinj.
 - Përgatitjen e propozimeve për financim dhe qasje të strukturuar tek donatorët.
 - Komunikim efektiv të mesazheve dhe prezantimin e punës së organizatës tek mbështetësit potencialë.
- Organizata të ketë një listë me mundësi konkrete financimi (donatorë, biznese, platforma digjitale) që mund të ndiqen pas punëtorisë.

- Të jetë krijuar një mekanizëm i brendshëm për ndarjen e roleve dhe përgjegjësi në procesin e mobilizimit të burimeve.
- Stafi të jetë më i motivuar dhe më i aftë për të kontribuar në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të organizatës.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së punëtorisë.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetim.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 01.09.2025** në prokurimi@nevokoncepti.org